

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË “DREJTORINË E PËRGJITHSHME E BURGJEVE”.

Raporti Përfundimtar i Auditimit i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme e Burgjeve, Tiranë me objekt “Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë financiar” për periudhën 01.01.2014 deri më 31.12.2015 si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH nr. 13, dt. 20.02.2016. Bazuar në nenet 15, 25, 30 dhe 32 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, me shkresën Nr.1132/8, datë 28.03.2016, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse i janë dërguar z Artur Zoto, Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve, ku janë rekomanduar dhe kërkuar zbatimi i masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Nga auditimi është konstatuar se gjatë vitit 2014, kanë ndodhur ndryshime të planit në rritje dhe në zbritje, kështu totali i pakësimeve për artikullin 600 – 601 ka qenë në vlerën 95,284,800 lekë, nga të cilat nga aparati 15,014,800 lekë, ndërsa nga sistemi 88,464,800 lekë. *Totali i shtesave në artikullin ‘602 shpenzime operative’ rezulton në vlerën 93,370,000 lekë, për të shlyer detyrimet e akumuluar të energjisë elektrike dhe ujit, nga të cilat 15,171,144 lekë ujë, 69,398,856 lekë për energjinë elektrike, 9,800,000 lekë paga dhe sigurime shoqërore.*

Për vitin 2014, nga auditimi është konstatuar se realizimi i fondeve buxhetore ka qenë në masën 98,31%, ardhur kryesisht si rezultat i shkurtimeve dhe lirimeve në organikën e sistemit të burgjeve në numrin 996 punonjës: 487 të larguar dhe 509 të liruar, nga ku ka rezultuar një tepricë në fondin e pagave në vlerën 93,370,000 lekë, rialokuar në artikullin ‘602 shpenzime operative’ për sistemin e burgjeve. Nga ky konstatim rezulton një risk operacional dhe financiar tepër i lartë për vitet e ardhshme, për shkak të detyrime për vendime gjyqësore në lidhje me largime/lirime nga puna. Fonde e lira janë përdorur për shpenzime udhëtimi të aparatit dhe për mbulimin e shpenzimeve gjyqësore të aparatit dhe sistemit të burgjeve përkatësisht në vlerën 22,544,842 lekë për aparatin dhe 16,334,158 lekë për sistemin e burgjeve, pra në total 41,079,400 lekë ose 4% i totalit të artikullit “602 shpenzime operative”.

Konstatuam se Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në situacionin vjetor të shpenzimeve buxhetore të sistemit të burgjeve nuk ka pasqyruar rialokimet (brenda artikullit 602) e miratuara.

Edhe për vitin 2015, konstatuam se ka pasur një programim jo të kujdesshëm lidhur me nevojat për fonde. Kështu, DPB në hartimin e buxhetit ka respektuar tavanet e vendosura nga Ministria e Financave, por nevojat për artikullin ‘600 & 601 paga dhe sigurime’ rezultojnë me rreth 646,224 mijë lekë më shumë se sa vlera e parashikuar në PBA. Ndërsa për artikullin ‘230 & 231 shpenzime kapitale’ plani sipas nevojave rezulton rreth 872,212 mijë lekë më tepër se vlera e vendosur si tavan dhe ajo e miratuar.

Gjatë vitit kanë ndodhur ndryshime të planit në rritje dhe në zbritje. Është konstatuar se kanë rezultuar teprica në fondin e pagave dhe sigurimeve shoqërore në vlerën 282,490,770 lekë për shkak të largimeve dhe lirimeve nga detyra gjatë vitit 2015 në numrin total 435 punonjës civil dhe ushtarak, nga të cilët 168 të larguar dhe 267 të liruar nga detyra, si edhe për shkak të vendosjes në punë me vonesë të IEVP Fier dhe Berat. Është konstatuar se në artikullin 602 shpenzime operative janë rialokuar fonde sipas nevojave në nën artikullin ‘6024 shpenzime udhëtimi’ të aparatit dhe në nën artikullin

‘6027 shpenzime për detyrime dhe kompensime’, kryesisht vendime gjyqësore të sistemit të burgjeve.

Me Aktin normativ nr. 1, datë 29.07.2015 ‘Për disa ndryshime në ligjin nr. 160/2014 “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar është miratuar shtesë buxheti në shumën 24,715,000 lekë, e cila është përdorur për likuidim detyrimesh të vendimeve gjyqësore të krijuara gjatë 5 muorit të parë të vitit 2015 nga DPB, IEVP Burrel dhe Tepelenë.

Për vitin 2015, shpenzimet e Drejtorisë së Përgjithshme të burgjeve dhe sistemit janë realizuar në masën 91.97%. *Realizimi në masën 91.83% në sistemin e burgjeve ka ardhur kryesisht nga mospërdorimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore.* Artikulli “231 investime” është realizuar në masën 25.75 për qind për shkak të mos dorëzimit të dy automjeteve të prokuruar për llogari të DPB nga Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Prokurimeve të Përqendruara në vlerën 11,408,000 lekë.

Nga auditimi është konstatuar se kanë rezultuar fonde të lira gjatë vitit 2015 të cilat me miratim të titullarit të DPB janë rialokuar për nevojat e aparatit dhe sistemit në nën artikujt të tjerë të artikullit 602, për shpenzime udhëtimi të aparatit në vlerën 1,800,000 lekë dhe për mbulimin e shpenzimeve të vendimeve gjyqësore të aparatit në vlerën 45,766,512 lekë.

Realizimi në % i artikullit 602 sipas situacioneve përcjellë Ministrisë së Drejtësisë rezulton të jetë më i lartë se sa buxheti i rishikuar për ta. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr. 13 - 24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga institucioni të ketë një politikë të kujdesshme të programimit dhe ndjekjes së zërave buxhetor, duke shpenzuar fonde vetëm brënda limiteve të përcaktuara dhe për të gjitha rialokimet të ketë një raportim të kujdesshëm dhe monitorim të zërave buxhetor.

Menjëherë

2. Nga monitorimi i buxhetit është konstatuar se për vitin 2014 janë dërguar raportet e monitorimit çdo tre muor në përputhje me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. Konstatohet se për tremujorin e parë, buxheti i DPB është realizuar në masën 21.04% ndërkohë që treguesit e monitorimit, tregojnë se janë krijuar detyrime për sa i përket pagesave të energjisë elektrike dhe të ujit, të cilat i janë shtuar detyrimeve të mëparshme të trashëguara nga viti para ardhës. Për gjashtë muorin, buxheti është realizuar në masën 46.17 %, referuar kryesisht artikujve 600, 601, 602 dhe 606, ndërsa realizimi për artikujt 230 dhe 231 është 0%. Për nëntë muorin, rezulton se buxheti është realizuar në masën 70.53 % kryesisht në artikujt 600 – 601, 602 dhe 606, si edhe 230, artikull i cili është realizuar në masën 18.35%. Nga DPB raportohet se detyrimet e krijuara nga faturat e energjisë elektrike dhe ujit janë shlyer falë rialokimit nga fondi i pagave të vlerës prej 93,370 mijë lekë dhe një fondi shtesë në vlerën 150,000 mijë lekë.

Për vitin 2015 sipas raporteve të monitorimit konstatohet se për tremujorin e parë, buxheti është realizuar në masën 20.04 % kryesisht për artikujt 600 – 601, 602 dhe 606. Për gjashtë muorin, buxheti është realizuar në masën 42.40 % kryesisht për artikujt 600 – 601, 602 dhe 606. Për nëntë muorin, buxheti është realizuar në masën 64.49% për artikujt 600 – 601, 602 – 606 dhe për artikullin 231 i cili është realizuar në masën 17.74 për qind *(trajtuar më hollësisht në faqen nr. 13 - 24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga institucioni të merren masa për të realizuar fondet jo duke i spostuar në fund të vitit pasi kjo sjell jo vetëm mos efektivitet por edhe mungesë eficiente të përdorimit të

fondeve. Nga ana tjetër duhet të ketë një vëmendje të shtuar për nivelin e detyrimeve që krijohen jo vetëm nga mungesa e likuiditetit por edhe nga probleme të administrimit.

Menjëherë

3. Nga auditimi është konstatuar se në DPB nuk respektohet kërkesa e vartësisë direkte të sektorit të protokoll arkivit nga titullari i institucionit, në kundërshtim me nenin 23 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”. Sektori i protokoll-arkivit ka kryer inventarin e dosjeve të depozituara në arkiv, por ky inventar nuk është kryer në përputhje me modelit nr.7 dhe modelin nr. 8 të normave tekniko-profesionale. Gjithashtu është konstatuar se institucioni mban një regjistër inventar i dosjeve, por ky nuk i përmbahet modelit nr. 14 të miratuar më normat tekniko profesionale. Nga auditimi është konstatuar se, nuk është hartuar Indeksi Alfabetik i Korrespondencës dhe Numërori sipas Modelit nr. 2 dhe nr. 3 në të cilët bëhet regjistrimi i dokumentit më të parë me të cilin ka filluar praktika, si edhe pasqyra emëruese e çeljes së dosjeve nuk është hartuar sipas specifikave të nenin 25 të normave tekniko profesionale dhe modelit nr. 5 të normave tekniko-profesionale. Nuk respektohen elementët e kapakut të dosjeve që dorëzohen në arkivin e institucionit, në kundërshtim me nenin 29 të normave tekniko profesionale dhe me modelin nr. 6 të normave tekniko profesionale. Gjithashtu, në elementët e kapakut të dosjeve mungon afati i shfrytëzimit të dosjeve dhe afati i ruajtjes. Për periudhën objekt auditimi në DPB nuk është kryer klasifikimi i dosjeve në administrim sipas afatit të ruajtjes; nuk janë hartuar listat e veçimit për ato dokumente që i kanë kaluar afatet e ruajtjes; nuk janë asgjësuar dokumente të cilëve u ka kaluar afati i ruajtjes; si dhe nuk janë evidentuar zyrtarisht dokumentet që kanë afatin e ruajtjes përgjithmonë. DPB nuk ka dorëzuar asnjëherë dokumente pranë arkivit të Ministrisë së Drejtësisë për shkak të mungesës së hapësirës pranë arkivit së këtij institucioni e për këtë arsye arkiva është e mbingarkuar me dokumente të pa klasifikuara dhe të pa dorëzuara.

Nga auditimi i kushteve të ruajtjes së dokumentacionit në arkivin e institucionit është konstatuar mungesa e hapësirave të përshtatshme dhe mungesa e ajrimit në veçanti në sallën e dytë ky janë arkivuar dokumentet. Për këtë arsye është i pamundur respektimi i dispozitave të përcaktuara nga normat tekniko profesionale në lidhje me kushtet e ruajtjes së dokumenteve në zbatim të nenit 99 – 106 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 *(trajtuar më hollësisht në faqen nr.47-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve të rishikojë vartësinë e sektorit të protokoll arkivit duke u bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2013 “Për Arkivat”.

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masa dhe të ngrejë një grup pune për të hartuar një Rregullore të Posaçme, e cila të reflektojë kërkesat e ligjit për arkivat si edhe të normave tekniko profesionale, duke parashikuar saktë në të praktikën dhe modelet standarde të punës në Sektorit të protokoll – arkivit. Të ngrihet një komision i ekspertizës i cili të hartojë listat e dokumenteve me rëndësi kombëtare dhe të dokumenteve me afat ruajtje të përkohshme, duke përcaktuar për këto të fundit afatet e ruajtjes.

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masa dhe të hartojë listat e veçimit si dhe të përcaktojë saktë në to listën e atyre dokumenteve, për të cilët ka kaluar afati i ruajtjes, si dhe të procedojë me procedurat e asgjësimit të tyre, duke vepruar në përputhje me dispozitat e ligjit për arkivat dhe normat tekniko – profesionale. Të bëhet evidentimi i dokumenteve të cilët duhen dorëzuar pranë arkivit të Ministrisë së Drejtësisë dhe të nisë praktikën shkresore për të kryer dorëzimin e dokumenteve.

Brenda 31.12.2016

4. Nga auditimi është konstatuar se Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave nuk ka ushtruar asnjëherë kontroll në lidhje me miradministrimin e fondit arkivor të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, si edhe është konstatuar se as vetë DPB nuk ka ushtruar kontrolle periodike të planifikuara ose të veçanta në kundërshtim me nenin 109 të normave tekniko profesionale të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 *(trajtuar më hollësisht në faqen nr.47 – 49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve të hartojë një plan kontrolli periodik vjetor me qëllim përmirësimin e punës dhe evidentimin e problematikave në lidhje me funksionimin e sektorit të protokoll – arkivit.

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të marrë masa për t'i siguruar sektorit të protokoll arkivit mbështetje tekniko - profesionale dhe metodologjike në lidhje me specifikat e punës arkivore dhe të protokollit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

5. Nga auditimi është konstatuar se dosjet e auditimeve të brendshme të Njesisë së Auditimit të Brendshëm nuk dorëzohen dhe nuk janë dorëzuar asnjëherë pranë arkivit së institucionit duke mos lenë gjurmë arkivore të auditimeve të kryera pranë IEVP të sistemit të burgjeve.

Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, për periudhën objekt auditimi nuk ka vepruar me organikë të plotë, pasi ka qenë në mungesë të një audituesi. Kjo mungesë është mbuluar pjesërisht duke filluar nga nëntori i vitit 2014 përgjegjësi i sektorit të financës së IEVP Fushë – Krujë, i cili është auditues i brendshëm i certifikuar, por që arrin të mbulojë pjesërisht fazën e punës në terren dhe e bën të vështirë fazën e raportimit *(trajtuar më hollësisht në faqen nr.44 – 47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve të procedojë me arkivimin e dosjeve të auditimit të brendshëm në zbatim të dispozitave të ligjit për arkivat dhe normave tekniko – profesionale.

Brenda 30.04.2016

Të merren të gjitha masat e duhura, në përputhje me dispozitat ligjore për statusin e nëpunësit civil, për plotësimin e organikës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm me qëllim mos cenimin e funksionimit normal të kësaj strukture të rëndësishme pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Brenda 31.12.2016

6. Nga auditimi i dosjeve të auditimit të brendshëm të IVSHB Tiranë (Spitali i Burgut) dhe IEVP Fushë – Krujë është konstatuar se në to është e dokumentuar puna audituese në përputhje me Manualin e Ministrisë së Financave për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik, por nuk është kryer një rishikim i përgjithshëm i punës audituese nga ana e drejtimit të institucionit, duke mos respektuar standardet e vendosura në Manualin e Auditimit të Brendshëm për sigurimin e cilësisë së punës së auditimit *(trajtuar më hollësisht në faqen nr. 44- 47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masa me qëllim që të hartojë procedura të sakta në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të auditimit si dhe me Manualin e Auditimit të Brendshëm, të përgatitur nga Ministria e Financave të Republikës së

Shqipërisë, për të kryer rishikimin në të ftohtë dhe në të nxehtë të punës audituese të Njesisë së Auditimit të Brendshëm.

Brenda 31.12.2016

7. Nga auditimi i procedurave të zbatimit të vendimeve të formës së prerë të gjykatave për punonjësit që janë larguar/kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës, u konstatua se në asnjë rast, nuk është bërë pagimi vullnetar i tyre, por ai është realizuar nëpërmjet Zyrave Përmbartimore, duke u shoqëruar me kosto shtesë për institucionin, për shkak të pagesave/tarifave përmbartimore. Gjatë vitit 2014 - 2015 u konstatuan pagesa me vlerë 7,380,896 lekë, për 178 raste për shkak të zbatimit forcërisht vendimeve të formës së prerë të gjykatave, të cilat përbëjnë dëm ekonomik të pa arkëtueshëm për buxhetin e shtetit *(trajtuar më hollësisht në faqen nr. 49 - 51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për sa më sipër rekomandojmë:

Detyrimet financiare për pagat e punonjësve të larguar padrejtësisht nga puna sipas vendimeve të formës së prerë të gjykatës, të regjistrohen në kontabilitetin përkatës të DPB. DPB, me paraqitjen e vendimeve të formës së prerë të gjykatave, të marrë masat e nevojshme duke vendosur detyrat konkrete për çdo hallkë të institucionit, për zbatimin vullnetar të vendimeve të formës së prerë të gjykatave. Në të kundërt, personat përgjegjës të zhdëmtojnë vlerën e shpenzimeve përmbartimore.

Në vazhdimësi

8. Gjatë vitit 2014 - 2015 ka zbatuar/paguar 178 vendime të formës së prerë të gjykatave. Në këtë numër vendimesh të gjykatave janë përfshirë dhe katër vendime, për të cilët gjykata është shprehur që ... *të paguhet detyrimi ... i vendimit të gjykatës së formës së prerë Pagesa do të vazhdojë deri në rikthimin e tij në punë, me një pagë mujore ...* Për këto raste DPB ka bërë pagesën, por paraprakisht nuk ka bërë verifikimin nëpërmjet institucioneve përkatës, nëse personi ka qenë i punësuar në vende të tjera pune, ose minimalisht të kërkojë/pranojë një deklaram nga personi objekt i vendimit të formës së prerë të gjykatës, se gjatë periudhës prej largimit nga detyra deri në zbatimin e vendimit të gjykatës, nuk ka qenë i punësuar në vende të tjera *(trajtuar më hollësisht në faqen nr. 49 - 51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për sa më sipër rekomandojmë:

DPB, me qëllim shmangien e pagesës për të njëjtën periudhë në dy vende pune shtet/ose privat gjatë zbatimit të vendimeve të formës së prerë të gjykatave, të verifikojë në bashkëpunim me institucione të tjera, ose minimalisht të kërkojë/pranojë një deklaram, nëse personi përfitues, objekt i vendimit të gjykatës ka qenë i punësuar në vende të tjera. Në rast se vërtetohet se ka qenë i punësuar, të ndalë menjëherë pagesën dhe për pagesat eventuale të kryera, të bëjë përlllogaritjet dhe të kërkojë kthimin sa më parë të shumave të përfituara padrejtësisht.

Në vazhdimësi

9.1 Nga auditimi i pasqyrave financiare të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve u konstatua se ka detyrime debitore me vlerë 25,742,194 lekë, të krijuar kryesisht prej vitit 2007. Përgjithësisht ato pasqyrojnë detyrime të subjekteve që ushtrojnë aktivitet dhe personave fizikë, për të cilët institucioni, nuk disponon të dhëna të azhurnuara mbi vendndodhjen e tyre e për rrjedhojë nuk ka bërë kërkesë për arkëtimin e tyre *(trajtuar më hollësisht në faqen nr. 28 - 31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e shumave nga personat juridik e fizik debitorë, me qëllim që këto që detyrime të realizohen si të ardhura për institucionin, para se këto të klasifikohen “pa shpresë arkëtimi” dhe të fshihen nga evidenca kontabile.

Menjëherë

9.2 Në inventar ka mjete kryesore, për të cilat norma amortizimi është llogaritur 30 për qind, në kundërshtim ligjin nr. 8438, datë 25.12.1998 “Mbi tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar për kompjuterët etj, duke rritur fiktivisht amortizimin e akumuluar të aktiveve të trupëzuara dhe ulur jetëgjatësinë e tyre. Në një rast për pajisjen me emërim “transformator” u konstatua mos përputhje midis vlerës së pasqyruar në librin e magazinës dhe regjistrimin kontabël duke rritur padrejtësisht vlerën e tij me 4,933,321 lekë *(trajtuar më hollësisht në faqen nr. 28 - 31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga sektori i financës të bëhen rregullimet përkatëse të normave të amortizimit në përputhje me ligjin nr. 8438, datë 25.12.1998 “Mbi tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, për të pasqyruar saktë amortizimin e inventarit ekonomik në evidencat kontabël, duke ruajtur jetëgjatësinë normale të tyre dhe evituar zhvlerësimin e parakohshëm të inventarit në përdorim. Sektori i financës dhe buxhetit të kryejë sistemimet e duhura në kontabilitet, në mënyrë që gjendja e aktiveve në pasqyrat financiare, të tregojë realisht vlerën e aktive të qëndrueshme të institucionit.

Në vazhdimësi

10. Nga auditimi i ushtruar u konstatua se në inventar ka pajisje elektronike dhe pjesë këmbimi për automjete, stok dhe me qarkullim të ngadalshëm me vlerë 2,851,482 lekë, të blera vite më parë, që nuk kanë mundësi përdorimi, pasi pajisjet/automjetet për të cilat ato janë blerë janë bërë dalje nga institucioni për shkak të konsumit/vjetërsisë së tyre dhe përdorimi/mirëmbajtja e mëtejshme e tyre nuk është ekonomike *(trajtuar më hollësisht në faqen nr. 28 - 31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të ngrihen komision i veçantë për vlerësimin e pjesëve të këmbimit etj, nëse ekziston mundësia që ato të përdoren dhe në pamundësi, të bashkëpunohet me institucione shtetërore, për faljen/shitjen e tyre me ankand etj.

Në vazhdimësi

11. Nga auditimi i kryer mbi veprimet me bankë për vitin 2014 u konstatua se, janë kryer 5 procedura prokurimi me vlera të vogla me objekt “Material zyre dhe të përgjithshme” me fond limit 558,428 lekë gjithsej, në kundërshtim me VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Mbi rregullat e prokurimit publik” të ndryshuar dhe udhëzimin nr. 2 datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”, VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësisve që varen prej tyre”, i ndryshuar, duke treguar një defekt në planifikimin e prokurimeve të së njëjtës natyrë në fillim të vitit *(trajtuar më hollësisht në faqen nr.26-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masa për të evituar copëzimin e fondeve gjatë procedurave të prokurimit me vlera të vogla në përputhje me VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Mbi rregullat e prokurimit publik” të ndryshuar dhe udhëzimin nr. 2 datë

28.03.2013 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël", të ndryshuar, si dhe të kryej një parashikim të mirëfilltë të fondeve në fillim të vitit.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI.

Të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **9,785,977 lekë** duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, si më poshtë:

1. OE [REDAKTUAR] sh.p.k. i cili ka furnizuar me gaz të lëngët DPB kryesisht gjatë viti 2014 vlerën **1,331,323 lekë** (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 31 – 34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2. OE [REDAKTUAR] i cili ka furnizuar me gaz të lëngët DPB kryesisht gjatë viti 2015 vlerën **3,279,097 lekë**, të cilat përfaqësojnë dëmin ekonomik të shkaktuar, për shkak të përfshirjes së "taksës së qarkullimit" në strukturën e çmimit gjatë zbatimit të kontratës, në kundërshtim me nenin 3 të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare" i ndryshuar dhe vet strukturën e llogaritjes së fondit limit nga BPB, të cilët nuk e përmbajnë "taksën e qarkullimit" (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 31 – 34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3. Katër personave sipas listës në vlerën 2,649,513 lekë, që përbën dëm ekonomik të kthyeshëm për buxhetin e shtetit, nga e cila:

- Vlera **1,048,763 lekë**, e cila përfaqëson shumën e pa ndalur të "tatimit mbi të ardhurat" që duhet të derdhet për llogari të Drejtorisë Rajonale të Tatim Taksave Tiranë,

- Vlera **1,600,750 lekë**, e cila përfaqëson sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të pa ndalura, që do të derdhen për llogari të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për shkak se gjatë zbatimit të vendimeve të formës së prerë të gjykatave, në të cilat ato janë shprehur ... *për pagesën e personit, deri në kthimin e tij në punë*, DPB, nuk ka ushtruar ndalesat për efekt të "tatimit mbi të ardhurat" dhe të "sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore", në kundërshtim me pikën 2.8 të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 23, datë 30.7.2014 "Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2014 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar në të cilën është përcaktuar se ... *në zbatim të nenit 8/1 të ardhura të përjashtuara, përjashtohen nga detyrimi për të paguar tatimin mbi të ardhurat personale ... Përfitimet për punonjësit e larguar nga puna për të cilët Gjykata ka vendosur kthimin në vendin e punës dhe përfitimin e pagës deri në momentin e kthimit në punë, nuk janë objekt përjashtimi* (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 49 - 51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4. DPB në bashkëpunim me Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe Ministrinë e Financave, për efekt të zbatimit të katër vendimeve të formës së prerë të gjykatave për personat sipas listës bashkëngjitur, në të cilat ato janë shprehur ... *për pagesën e personit, deri në kthimin e tij në punë*, të marrë masat e nevojshme për të siguruar derdhjen në fondin e sigurimeve shoqërore të shumës së munguar prej **2,526,044 lekë**, e cila përfaqëson detyrimet e pa paguara të punëdhënësit/institucionit ndaj punëmarrësit/personave që kanë fituar procesin gjyqësor (trajtuar më hollësisht në faqen nr.49-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5. Komisionit të Blerjeve me vlera të vogla vlerën **32,306 lekë**, e cila përfaqëson rritjen padrejtësisht të fondit limit në tenderin me objekt "Shpenzime mirëmbajtje ndërtesa IEVP Vaqar" (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 49 - 51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

C. DËM EKONOMIK, PA MUNDËSI ARKËTIMI NË VLERËN 168,060,320 MIJË LEKË.

Ky dëm është efekt i drejtpërdrejtë i zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, i cili përkufizohet si dëm ekonomik i pa arkëtueshëm, për shkak se nuk mund të përcaktohet përgjegjësia, nga i cili:

a. 160,679,433 lekë, efekt i drejtpërdrejtë i zbatimit të vendimeve të gjykatave.

Në fillim të vitit 2014, për efekt të zbatimit të vendimeve gjyqësore të vitit 2013, janë trashëguar 37 kreditorë me efekt në buxhetin e shtetit 22,672,895 lekë. Gjatë vitit 2014 janë shtuar 61 kreditorë të tjerë në vlerë 49,481,074 lekë gjithsej, duke e çuar numrin e vendimeve gjyqësore për t'u ekzekutuar në 98 ish punonjës (kreditorë) me efekt në buxhetin e shtetit 72,153,969 lekë. Nga këto, gjatë vitit 2014 janë ekzekutuar vendimet e gjykatave për 97 kreditorë në vlerë 71,534,564 lekë.

Gjatë vitit 2015 janë shtuar 80 kreditorë të tjerë në vlerë 88,525,464 lekë gjithsej, duke e çuar numrin e vendimeve gjyqësore për t'u ekzekutuar në 81 kreditorë me efekt në buxhetin e shtetit 89,144,869 lekë. Nga këto, gjatë vitit 2015 janë ekzekutuar vendimet e gjykatave për 81 kreditorë me efekt negativ në buxhetin e shtetit prej 89,144,869 lekë. Për të dy vitet së bashku janë ekzekutuar vendime të formës së prerë të Gjykatës për 178 kreditorë, me vlerë 160,679,433 lekë.

b. 7,380,896 lekë, për 178 raste për shkak të zbatimit forcërisht vendimeve të formës së prerë të gjykatave.

Nga auditimi i procedurave të zbatimit të vendimeve të formës së prerë të gjykatave për punonjësit që janë larguar/kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës, u konstatua se në asnjë rast, nuk është bërë pagimi vullnetar i tyre, por ai është realizuar nëpërmjet Zyrave Përmbartimore, duke u shoqëruar me kosto shtesë për institucionin, për shkak të pagesave/tarifave përmbartimore.

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, pika b, në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në referim të nenit 57, 58, 59 të ligjit nr. 152/2013, datë 13.05.2013 “Statusi i nëpunësit civil”, kreu II i VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve, si dhe përgjegjësi individuale të evidentuara dhe pasqyruar në procesverbalet dhe aktverifikimet përkatës, vërejtjeve të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit të vlerësojë shkeljet e konstatuara, dhe të vendosë marrjen e masave administrative dhe disiplinore, në raport me shkeljet e konstatuara.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit: Fatmir Zilja (përgjegjës grupi), Xhuljeta Çelaj dhe irma Idrizaj më tej materiali u shqyrtua nga kryeaudituesi, drejtori i departamentit juridik dhe zbatimit të standardeve dhe drejtori i departamentit.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT